REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr7270 Prot

Lushnje, më 26/08/2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE BASHKIA LUSHNJE "

Plani i Mbarështimit të Pyjeve të Bashkisë Lushnje është një dokument strategjik afatgjatë, i hartuar në përputhje me ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet" dhe aktet nënligjore në fuqi, me qëllim përdorimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen afatgjatë të fondit pyjor publik dhe privat në territorin e bashkisë.

Dokumenti bazohet në një analizë të detajuar të gjendjes aktuale të pyjeve, duke marrë parasysh sipërfaqen dhe shpërndarjen gjeografike të masiveve pyjore dhe gjendjen e biodiversitetit dhe habitateve. Si dhe kërcënimet aktuale si shpyllëzimi, zjarret, prerjet e paligjshme dhe degradimi i tokës dhe nevojat për rehabilitim dhe rimbjellje.

Plani ka si objektiva kryesore:

- Mbrojtjen dhe konservimin e fondit pyjor;
- Rimbjelljen dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të degraduara;
- Menaxhimin e qëndrueshëm për përdorim ekonomik, social dhe mjedisor;
- Forcimin e kapaciteteve institucionale të Bashkisë për administrimin e pyjeve;
- Ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e pyjeve dhe pjesëmarrjen e tyre në mbrojtje.

Plani i Menaxhimit të Pyjeve përfshin:

- Hartën e shpërndarjes së pyjeve dhe ndarjen sipas tipologjisë;
- Programin e masave prioritare ;

- Vlerësimin e burimeve financiare të nevojshme dhe burimet e mundshme të financimit (buxheti vendor, fondet qendrore, projektet ndërkombëtare);
- Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit.

Ky plan është një mjet kyç për:

- Zbatimin e angazhimeve mjedisore të Bashkisë Lushnje;
- Ruajtjen e ekuilibrave ekologjikë;
- Përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit;
- Rritjen e potencialit ekonomik përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore

Ky dokument është një instrument strategjik për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve në Bashkinë Lushnje dhe *ka kaluar në Konsultim publik në ambientet e Muzeut Historik Lushnje në datën 15.08.2025 me proces-verbal nr. 7019 prot. datë 15.08.2025. Gjatë konsultimit kishte pyetje mbi masat e marra dhe mbi ngritjen e grupeve të vrojtimit si dhe diskutime të tjera të cilat janë të paraqitura në process-verbal.*

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa



Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr 7270/1 Prot

Lushnje, më 26 / 08 /2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. 79 Datë 26/08/2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE BASHKIA LUSHNJE "

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, neni 27 pika 5,neni 54,shkronja " k", Ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet",VKM-nr 814 date 31.12.2018 "Për miratimin e dokumenit të Politikave për Pyjet në Shqipëri 2019-2030", Udhëzimet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve, propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak Lushnje, "Plani Mbarështimit të Pyjeve Bashkia Lushnje".

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e dokumentit "Plani i Mbarështimin të Pyjeve, Bashkia Lushnje", sipas kërkesave të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjit nr. 57/2020 "Për Pyjet".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky Vendimin hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sektori i Pyjeve dhe Kullotave
Erion Hasani

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E_mail:bashkia_lushnje@yahoo.com